



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Datë: 23.12.2022 Ref.: 2112/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 107-të, të mbajtur me datë 24.11.2022, mori:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës Nr.prot:1782/22 e datës 20.10.2022 për përmirësim të Njoftimit nr.315/10 të datës 31.03.2010.
- II. Përmirësohet/ndryshohet emërtimi i programit të studimit nga: Prodhim dhe Automatizim BEng/MEng siç ka qenë në paragrafin A, pika 1, të Njoftimit nr.315/10, në **Prodhimtari dhe Automatizim BEng/MEng**
- III. Përmirësohet/ndryshohet emërtimi i programit të studimit nga: Termoteknologji dhe Termoteknikë BEng/MEng siç ka qenë në paragrafin A, pika 2, të Njoftimit nr.315/10, në **Termoenergjetikë dhe Termoteknikë BEng/MEng**.
- IV. Përmirësohet/ndryshohet emërtimi i programit të studimit nga: Ndërtim dhe Projektim BEng/MEng siç ka qenë në paragrafin A, pika 3, të Njoftimit nr.315/10, në **Konstruksion dhe Dizajnim Beng/MEng**.
- V. Përmirësohet/ndryshohet emërtimi i programit të studimit nga: Trafik dhe Transport BEng, siç ka qenë në paragrafin B, pika 1, të Njoftimit nr 315/10, në **Komunikacion BEng**.
- VI. Pjesa tjetër e Njoftimit nr.315/10 të datës 31.03.2010 mbetet e pa ndryshuar.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M

- I. Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA), me datë 20.10.2022 ka pranuar kërkesën e Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës Nr.prot:1782/22 për përmirësim të Njoftimit nr.315/10 të datës 31.03.2010. Kërkesa është proceduar për shqyrtim në mbledhjen e 107-të të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, mbajtur me datë 24.11.2022.
- II. KShC ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin e referuar në kërkesë, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Assoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë